



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
GJIROKASTER

FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS  
DEPARTAMENTI I MATEMATIKËS, INFORMATIKËS DHE FIZIKËS

**RAPORT I VEPRIMTARISË  
MËSIMORE DHE SHKENCORE  
PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020**

Gjirokastrë, Dhjetor 2020



Raporti i veprimtarisë mësimore – shkencore është hartuar bazuar në raportet e Grupeve mësimore – kërkimore si dhe në raportet individuale, në ndjekjen e përditësuar të realizimit të programit mësimor, në vëzhgime, analiza, kontrole të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta në vazhdimësi si dhe në vlerësimin e dokumentacionit ligjor që posedon stafi dhe departamenti.

#### **Fushat kryesore të veprimtarisë së Departamentit gjatë vitit akademik 2019-2020.**

- Përmirësimi në vazhdimësi i mësimdhënies.
- Realizimi i plotë me cilësi dhe performancë i procesit mësimor nëpërmjet të dyja formave të mësimdhënies, si në auditor ashtu edhe të mësimin në distance (online)
- Vazhdimi i procesit të kualifikimit të stafit akademik në të gjitha nivelet dhe drejtimet.
- Pjesmarrja e stafit akademik në aktivitetet shkencore brenda dhe jashtë vendit.
- Pjesmarrja e stafit akademik në fushën e kërkimit dhe botimi i arritjeve në fushën e kërkimit brenda dhe jashtë vendit, në revista dhe organe prestigjioze.
- Plotësimi, përgatitja dhe ruajtja e dokumentacionit të domosdoshëm për mbarrëvatjen e procesit mësimor dhe shkencor.
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga stafi dhe infrastruktura e laboratorëve.
- Marrja e masave për minimizimin deri në eliminim të problematikave të konstatuara.
- Sigurimi i asistencës së nevojshme për të gjithë studentët dhe sidomos për mbarrëvatjen e tyre në lidhje me tregun e punës dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre.
- Bashkërendimi i veprimtarisë mësimore midis departamenteve të Fakultetit dhe të Universitetit.
- Sigurimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit me institucione të tjera universitare brenda dhe jashtë vendit.

#### **A. VEPRIMTARIA SHKENCORE**

Përbën një nga drejtimet kryesore të punës së stafit të departamentit e cila është zhvilluar në disa drejtime si:

- a. Zhvillimi i kurikulave, planeve mësimore, cikleve të ligjëratave, konform udhëzimeve dhe ligjit të arsimit të lartë.
- b. Kualifikimi individual, që ka të bëjë me përfshirjen e personelit sipas statusit të kualifikimit në procesin e avancuar të formimit profesional të tyre përkatesisht në doktoraturë, Prof.asoc dhe Prof.
- c. Aktiviteti botues në periodikët brenda dhe jashtë vendit.
- d. Pjesmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.
- e. Pjesmarrja në veprimtari jashtë universitare të lidhura me performancën arsimore.



## Rezultatet e punës kërkimore shkencore:

- Gjatë vitit akademik 2019-2020 ka vijuar puna për perfeksionimin e ciklit të leksioneve në strukturë, përmbatje dhe mënyrën e realizimit të tyre si në auditore ashtu edhe në përdorimin e formave elektronike të mësimi, për disiplina të programeve të ciklit të parë Bachelor dhe të ciklit të dytë Master në Mësuesi.
- Përmirësimi i programeve mësimore është zhvilluar tërësisht konform kërkesave të udhëzimeve dhe ligjeve përkatëse.
- Kualifikimi individual ka qënë pjesë e punës vjetorë të stafit. Aktualisht nga 15 anëtarë të stafit akademik te Departamentit për vitin akademik 2019-2020, 1 është Prof.asoc, 3 janë Doc.Dr, 1 është Doc.M.Sc, 5 janë Dr., 3 janë në proces doktrate dhe 2 janë M.Sc (në pritje të hapjes nga MASR të shkollës së doktoratave).
- Pjesë e veprimtarisë vjetore ka qënë dhe pjesëmarrja aktive dhe pasive në konferenca ndërkombetare e kombëtare brenda dhe jashtë vendit si dhe botimi në revista shkencore ndërkombetare e kombëtare.

## Aktiviteti Kualifikues.

Aktiviteti kualifikues i personelit akademik të Departamentit, ka konsistuar në:

- Vazhdim i punës kualifikuese për titull Prof.Asoc. (A. Isufati, K. Naka, R. Mano, K. Zoto, Dh. Terpo, A. Sinani, I. Kokalari)
  - Vazhdimi i punës në kuadër të disertacionit të doktoratës (R. Vasili, B. Rama, I. Selmani)
  - Në pritje për regjistrim dhe fillim të studimeve në shkollën e doktoratës (K.Lili, I. Bilo).
- Në vijim gjenden në mënyrë analitike dhe sesiore keto veprimtari.

## TË DHËNA PERMBLEDHESE PËR AKTIVITETIN KËRKIMOR - SHKENCOR TË PERSONELIT AKADEMIK TE DEPARTAMENTIT MATEMATIKE, INFORMATIKE DHE FIZIKË (VITI AKADEMIK 2019-2020)

| Nr. | Emertimi i zerave                                | Nen/zera                                 | Sasia ne n/zera | Sasia ne total | Verejtje |
|-----|--------------------------------------------------|------------------------------------------|-----------------|----------------|----------|
| 1.  | Artikuj shkencore                                | Brenda vendit                            | 1               | 5              |          |
|     |                                                  | Jashte Me Faktor Impakti                 | 4               |                |          |
|     |                                                  | Vendit Pa faktor Impakti                 |                 |                |          |
| 2.  | Referime ne Konferenca shkencore                 | Kombetare                                |                 | 8              |          |
|     |                                                  | Nderkombetare                            |                 |                |          |
|     |                                                  | Kombetare                                |                 |                |          |
| 3.  | Referime ne Konferenca te botuara ne Proceedings | Nderkombetare                            |                 | 8              |          |
| 4.  | Tekste universitare                              |                                          | 8               |                |          |
| 5.  | Tekste parauniversitare                          |                                          | 2               |                |          |
| 6.  | Tekst-maket universitar                          |                                          |                 |                |          |
| 7.  | Cikle leksionesh                                 |                                          |                 |                |          |
| 8.  | Monografi                                        |                                          | disa            | disa           |          |
| 9.  | Udheheqje shkencore                              | Doktorature                              |                 |                |          |
|     |                                                  | Master Shkencor/Profesional              |                 |                |          |
|     |                                                  | Diplome Bachelor                         |                 |                |          |
| 10. | Oponence                                         | Bachelor, Master/ Profesional & Shkencor |                 |                |          |
|     |                                                  | Doktorature                              |                 |                |          |



|     |                                                                                                    |                                                   |        |        |  |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|--------|--------|--|
| 11. | Pjesmarrje ne aktivite shkencore (pa referim)                                                      | Konferenca<br>Eorkshop<br>Seminare etj.           |        |        |  |
| 12. | Leksione te hapura ne UGJ / Universitete te tjera                                                  |                                                   |        |        |  |
| 13. | Trajnim i stafit akademik                                                                          |                                                   |        |        |  |
| 14. | Trajnime te mesuesve                                                                               |                                                   | 5      | 5      |  |
| 15. | Aktivite te organizuar ne UGJ                                                                      |                                                   |        |        |  |
| 16. | Aktivite te organizuar me aktore te tjere (university, qendra kerkimi dhe locale)                  |                                                   |        |        |  |
| 17. | Plane mesimore                                                                                     | Hartime te reja<br>Permiresime                    |        |        |  |
| 18. | Programe mesimore                                                                                  | Hartime te reja<br>Permiresime                    |        |        |  |
| 19. | Artikuj shkencore ne pub-<br>licistike                                                             | Ne revista e gazeta shkencore                     |        |        |  |
| 20. | Pjesmarrje ne projekte                                                                             |                                                   |        |        |  |
| 21. | Studente te perfshire ne projekte, etj                                                             |                                                   | 2      | 2      |  |
| 22. | Analiza shkencore (re-view)                                                                        |                                                   |        |        |  |
| 23. | Pjesmarrje ne borde editorial<br>periodikesh                                                       | Brenda vendit<br>Jashte vendit                    | 2<br>2 | 2<br>2 |  |
| 24. | Recensa shkencore per artikuj<br>shkencore                                                         | Brenda vendit<br>Jashte vendit                    |        |        |  |
| 25. | Artikuj shkencore derguar per<br>botim ne proces recense                                           | Brenda vendit<br>Jashte vendit                    | 1<br>1 | 2      |  |
| 26. | Pjesemarrjes aktive ne rrjetet<br>nderkombetare te<br>institucioneve te kerkimit dhe<br>zhvillimit |                                                   |        |        |  |
| 27. | Pjesmarrje ne Juri vlere-simi                                                                      | Ne Juri Doktoratash<br>(Oponente)                 |        |        |  |
| 28. | Studime Postdoktorale                                                                              | Jashte vendit                                     |        |        |  |
| 29. | Tituj dhe grada te fituara<br>(ose ne proces)                                                      | Profesor<br>Prof.asoc.<br>Dr.<br>Docent<br>Master |        |        |  |

Në të ardhmen (vitin akademik 2020-2021) në kuadër të veprimtarisë shkencore synojmë:

- Vazhdimin e punës për përmirësimin në mënyrë sa më shkencore dhe bashkëkohore të cilësisë së përmbajtjes së leksioneve
- Pjesëmarrja në vazhdimësi në projekte kërkimore kombëtare, por kjo kërkon dhe sigurim financimi të planifikuar nga sektori i kerkimit shkencor në rang universiteti.
- Vazhdimi më me intesitet i studimeve dhe botimeve sipas fushave përkatëse të punimeve shkencore në revista prestigjioze brenda dhe jashtë vendit.
- Ndjekja në vijueshmëri e procesit të kerkimit shkencor sipas planeve të aktivitetit të hartuar nga secili pjestar i stafit.
- Megjithëse i gjithë stafi i departamentit është në një proces të vazhdueshëm pune kërkimore me kërkime, analiza, pjesmarrje, botime, referime, etj ne do të synojmë të puna kërkimore krijuese e tyre të jetë sa më aktive duke ju mundësuar kushte sa më të përshtatshme.





- f. Do të synojmë që stafi të motivohet për tu përfshirë sa më shumë në projekte lokale, rajonale, ndërkombëtare, individuale apo në bashkëpunim të kërkimit shkencor.
- g. Do të synojmë përfshirjen e studentëve në grupe pune kërkimore për të qënë pjesë aktive dhe vijueshmërie e kërkimit universitar, kjo sidomos për studentët e programeve të ciklit të dytë.
- h. Do të synojmë gjetjen e rrugëve efikase për promovimin e veprimtarisë së departamentit nëpërmjet pjesmarrjes, aktiviteteve universitare dhe më gjerë.

## B. PROCESI MËSIMOR

- Realizimi me sukses i procesit mesimor të vitit akademik 2019-2020, në të dyja format e mësimdhënies (auditor dhe mesimit në distancë)
- Realizimi me sukses të plote i praktikave profesionale dhe mësimore sipas specifikave të programit dhe grupeve mësimore.
- Realizimi konform rregullores i provimeve, formave të tjera të kontrollit dhe proves finale.
- Organizimi i fillimit të procesit mesimor për vitin akademik 2020-2021
- Hartimi dhe përmirësimi i programeve të lendeve mesimore për vitin e ri akademik 2020-2021.
- Përmirësimi i materialeve mësimore të lendeve përkatëse sipas çdo programi për të qënë koherent me kërkesat e teknologjisë së prezantimit dhe të informimit sipas përmbatjes.

Sipas evidencimeve të realizuara për vitin akademik 2019-2020, bazuar dhe në monitorimin e kryer nga struktura drejtuese të Universitetit rezultojnë se veprimtaria e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës është karakterizuar nga një punë intesive dhe në vazhdimësi për përdorimin dhe aplikimin e metodave mësimdhënëse efektive, për transmetim dijesh bashkëkohore të pasqyruara në strukturën dhe përmbatjen e leksioneve, laboratorëve, praktikave dhe seminareve. Njëkohësisht dhe organizimi i mësimdhënies nga shumica e stafit akademik ka qënë me forma atraktive ku duhet përmendur përdorimi krahas metodave klasike në auditor edhe forma e mesimit në distancë (online).

Procesi mesimor i semestrit të parë është zhvilluar pranë auditoreve të Universitetit. Procesi mesimor i semestrit të dytë perkoi me masat e ndërmarra nga institucioni ynë, në kushtet e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga Pandemia e Covid-19, për përmbylljen me sukses të vitit akademik 2019-2020 dhe për pasojë mësimi u zhvillua në distancë (online), duke përdorur platformat ueb të mësimdhënies si Classroom, Edumeet dhe Zoom. Edhe pse një formë e re e mësimdhënies, me gjithë vështirësitë e hasura si pasoje e aftësive në përdorimin e këtyre platformave, si dhe problematikave në infrastrukturën e nevojshme për përdorimin e tyre nga ana e stafit akademik dhe studentëve, procesi mesimor u realizua me sukses. Bazuar në udhëzimin Nr. 104 datë 30.04.2019 të MASR-it para sezonit të provimeve për disa javë u zhvilluan gjithashtu një cikël përmbledhës për përsëritjen e leksioneve si dhe zhvillimi i orëve laboratorike të programeve mësimore në auditoret e Universitetit.

Por në tërësi realizimi i procesit mesimor ka akoma vend për përmirësime të mëtejshme cilësore dhe sasiore. Kështu në seancat ushtrimore dhe laboratorike studentëve duhet që t'u ofrohet literature dhe bazë materiale më e bollshme për demonstrime dhe përfundim shprehish për, ç'ka mos pajisja në kohë deri në mungesë, ka sjellë jo pak vështirësi.



Nje problematikë e ndjeshme është pjesmarrja e studentëve në leksione, seminare, ushtrime dhe laboratorëve. Kjo është e lidhur me disa elemente, por mendojme se politika e liberalizimit sidomos në përqindjen e ndjekjes së tyre dhe mos penalizimi në fund të vitit, madje duke krijuar akses hyrje në provim në vjeshtë kanë influencuar ndjeshëm në braktisjen e procesit mësimor. Por dhe stafi ne disa raste është treguar jo ekzigjent në cilësimin e orës së mësimi si të shenjtë dhe se çdo student që paraqitet kërkon dhe jemi të detyruar ti ofrojmë dije cilësore.

### **Kontrolli dhe vlerësimi i njohurive.**

Në drejtim të mbarëvatjes së procesit të vlerësimit gjatë vitit akademik 2019-2020 rezulton se:

- Provimet në secilin cikël studimesh janë zhvilluar në përgjithësi korekte në përputhje me rregulloren e Departamentit dhe të Fakultetit.
- Në secilën lëndë mësimore që është zhvilluar provimi, komisioni ka vepruar konform rregullores.
- Studentët në çdo provim janë përballuar me 5 variante të kontrolluara që ezaurojnë pothuajse të gjithë programin mësimor.
- Fletoret e përdorura në provim kanë qenë të sekretuara dhe janë përdorur konform rregullave të provimit.
- Komisioni i provimit në përgjithësi ka përdorur vlerësim në fletore analitik
- Vlerësimi i studentëve në përgjithësi është pasqyruar direkt në Proces verbal
- Problem deri diku ka qenë komunikimi në kohe i rezultatit të provimit të studentët dhe hedhja e notave në sistem.
- Nga analiza pamore e procesverbaleve rezulton se ka një nivel të ulët të përgatitjes së studentëve në çfaredolloj forme vlerësimi.

### **Praktika profesionale .**

Gjatë vitit akademik 2019-2020 edhe pse në kushtet e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore, të shkaktuar nga Pandemia e Covid-19, u realizua me sukses praktika profesionale nga studentët e programeve të ciklit të dytë të studimit Master në Mësuesi. Praktikën profesionale studentët e zhvilluan pranë auditoreve të Universitetit, nën drejtimin e pedagogëve metodistë të Departamentit, ku njëri prej kandidatëve luajti rolin e mësuesit, kurse pjestarët e tjerë e të grupit ishin në rolin e nxënësit, në bazë të një rotacioni ose grafiku të përcaktuar qysh me parë nga pedagogu metodist. Në përfundim të praktikës profesionale u realizua dhe vlerësimi i ecurisë dhe rezultateve të studentëve .

### **Marrëdhënie dhe veprimtari brenda dhe jashtë institucionale.**

Për mbarëvatjen e procesit mësimor departamenti ynë ka synuar të siguroj një bashkëpunim të mirë me autoritet drejtuese por dhe me departamentet simotra. Kështu kemi patur bashkëpunim të mirë me Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore për realizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë Master në Mësuesi, megjithë specifikat e tij në mënyrën e organizimit dhe zhvillimit të programit mësimor.

Veprimtaria e Departamentit tonë është shtrirë jo vetëm brenda njësive drejtuese të Universitetit tonë, por një bashkëpunim të mirë kemi patur me Departamentin e Matematikës, Departamentin



e Matematikës së Zbatuar dhe Departamentin e Informatikës së Fakultetit të Shkencave të Natyrës, të Universitetit të Tiranës nëpërmjet ftesave për bashkëpunim apo pjesëmarrjes në veprimtari promovuese të stafit tonë.

Një punë dinjitoze dhe me përgjegjësi profesionale është bërë dhe nga anëtarët e Departamentit të zgjedhur në organet drejtuese kolegjiale për prezantimin dhe argumentimin e ideve mbi përmbajtjen dhe realizimin e misionit të Universitetit në tërësi dhe të Departamentit në vecanti.

#### **Masat e fillim vitit akademik 2020-2021.**

Nderkohë që për vitin akademik 2019-2020 puna ka filluar pozitivisht në aspektin organizativ ku:

- Është njohur stafi i departamentit me udhëzimet e ministrisë dhe institucionit tonë për fillimin dhe mbarëvatjen e procesi mësimor në fomen e mësimdhënies në distancë.
- Është bërë trajnimi dhe ka nisur mesimdhënia nëpërmjet platformës online Office 365 nga stafi akademik.
- Bazuar në Udhezimin Nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mesimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë" janë përcaktuar ngarkesat mësimore të stafit akademik.
- Po hartohen programet dhe planet kalendarike përkatëse konform planeve mësimore që zbatohen në secilin program studimi
- Janë hartuar oraret mësimore dhe strukturat mësimore përkatëse për secilin program studimi dhe sistem studimi.
- Departamenti ka siguruar mbulimin e plotë të lendeve mësimore që zhvillohen gjatë këtij viti akademik duke mbuluar lendet sipas rëndësisë dhe kualifikimit të stafit akademik.
- Vazhdon puna e secilit pedagog për të mundësuar sigurimin e bazës materiale shkencore (leksione) për secilin student në format e ndryshme të mundshme.

Me qëllim rritjen e performancës së departamentit në përmbajtje një punë e mirë është bërë nga stafi, përgjegjësat e grupeve mësimore dhe përgjegjësi departamentit në drejtim të përmirësimit të cilësisë së programeve mësimore në të gjitha programet që ofron departamenti ynë.

Meqënëse u bënë disa vite që numri dhe cilësia e studenteve që aplikojnë për studime në programet që ofron departamenti ynë ka rënë, politika jone ka synuar në informimin masiv për mundësitë që ofrojnë programet tona, gadishmërinë dhe cilësinë e stafit, lehtësirat proceduriale që ofrojmë në rast integrimi programesh, kur vijnë nga degë të përafërta dhe që kanë ndërprerë studimet, si dhe fleksibiliteti i zhvillimit të programit përkatës.

Për të mundësuar vijueshmëri në sasi dhe cilësi, vëmendja e punës së stafit ka qenë informimi dhe marrdhënia me studentet, ku që në fillim të vitit akademik janë njohur me planin mësimor, programin e studimit, rregulloren e departamentit, Universitetit, statutin dhe të gjithë elementet teknike të mbarëvatjes së procesit mësimor.

#### **Detyrat për të ardhmen.**

Megjithëse departamenti ynë ka patur rezultate në procesin mësimor, evidente është kërkesa për përmirësim të mëtejshëm sasior dhe cilësor.



1. Do të vazhdoj puna për përdorimin në vazhdimësi të burimeve të informacionit sa më bashkëkohorë dhe atraktive, sidomos në lëndet përshkruese.
2. Do të insistojmë për sigurimin e një procesi mësimor sa më atraktiv me bazë mësimore sa më bashkëkohore dhe shkencore, megjithëse vazhdon vështiresia e sigurimit të literaturës së duhur konform kërkesave të stafit nëpërmjet fondit të akorduar nga universiteti, për të cilin duhet të investojmë akoma më shumë në të ardhmen.
3. Do të vazhdojë komunikimi dhe informimi i studenteve që mbarojnë programet e studimit pranë departamentit tonë.
4. Performanca dhe zbatimi i ligjshmërisë nga stafi akademik dhe ndihmës akademik është detyrë dhe do të jetë pjesë e investigimit në vazhdimësi.

Dr. Dhori TERPO

Përgjegjës i Njesisë Bazë

